



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

REALIZIMI I TREGUESVE EKONOMIKE-FINANCIARË TË
RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR
2021

A.Struktura e të ardhurave të RTSH gjatë vitit 2021

Burimet, nëpërmjet të cilave RTSH ka realizuar të ardhurat gjatë vitit 2021 janë:



-Realizimi i të ardhurave në krahasim me parashikimn buxhetor te vitit 2021:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Parashikim Viti 2021	Realizimi Viti 2021	% e realizim
I.	Financimi nga buxheti	606,000	573,736	95
a	Bashkatdhetarët&Sateliti	220,000	220,000	100
b	Projekte Filmike&Artistike	60,000	60,000	100
c	Orkestra Simfonike RTSH	60,000	60,000	100
d	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	216,000	216,000	100
d.1	Projekte Tekn.Teknologji te reja Investime	50,000	17,736	35
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,450,000	1,363,257	94
III.	Të ardhura te institucionit	400,000	296,943	74
	Sherbim ambjente transmetuese,tr.fm	150,000	137,397	92
	Reklama,njoftime etj.	200,000	143,546	72
	Të ardhura të tjera	50,000	16,000	32
	TOTALI	2,456,000	2,233,936	91

Të ardhurat janë realizuar në masën 91% në krahasim me parashikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 222 milione leke.

Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave paraqitet:

I-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në nivelin 95%.

a) Në Programin e parë Bashkatdhetarët dhe Shërbimi Satelitor, në zbatim të nenit 116/a,b,c të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” perfshin :

a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;

c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

është tërhequr financimi në vlerën totale 220,000,000 lekë, duke u realizuar 100% .

b) Në Programin Projekte Filmike e Artistike, në zbatim të nenit 116/d të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/d) *Projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja*; është tërhequr financimi buxhetor në vlerën totale 60 mln lekë për projektet filmike e artistike parashikuar për vitin 2021: Eurosong 2021 (13 mln lekë), Junior Eurosong(3 mln lekë), Festivalin e 60-të Këngës në RTSH, programet artistike, filmike, festive të fundvitit (44 mln lekë).

c) Në Programin e dytë Orkestra Simfonike e RTSH-së, në zbatim të nenit 116/dh të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ dh) *orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë*, është tërhequr financimi në vlerë totale 60 mln lekë. *Ndonëse shpenzimet janë tërhequr nga buxheti 100% në nivelin e planifikuar, në fakt RTSH ka mbuluar diferencën e shpenzimit të këtij zëri në vlerën ~12 mln lekë nga të ardhurat e veta.*

d) Në Programin e Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja, në zbatim të nenit 116/ç të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit”/ ç) *projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; parashikuar si vijon:*

d.1) Investime në Teknologji parashikuar në vlerën ~50,000,000 lekë janë realizuar në masën 35%. Investimet e realizuara gjatë vitit 2021 përfshijnë:

**Investime “Blerje pajisje dhe software për postën elektronike të RTSH-së”, “Blerje transmetuesash dhe sisteme antene FM për pesë stacione të RTSh-së”, të realizuara 100%. Mosrealizimi ka ndodhur në procedurën e tenderimit “Blerje Videowall, Televizor, pajisje ndricimi dhe rinovim i pajisjeve elektrike për studiot në RTSH”, procedurë e cila u realizua në mënyrë pjesore, pasi nuk mbërriten brenda afateve kontraktore të gjitha mallrat e parashikuara.*

d.2) Shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj. në vlerën 216 milion lekë, nëpërmjet të cilës është likuiduar detyrimi kontraktor për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit gjatë vitit 2021. Në fakt, kjo vlerë e financuar nga buxheti i shtetit është ~54 milion lekë më pak se shpenzimi faktik, që është bere pergjate

gjithe vitit 2021, bazuar në kontratën e këtij shërbimi (qe eshte paguar nga te ardhurat e veta te RTSh).

II. E ardhura nga tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive.

Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive është realizuar në masën 94% në krahasim me planin vjetor, ose mosrealizim në vlerë absolute ~86.7 milion lekë.

Gjatë vitit 2021, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa përfshijnë një periudhë 13 mujore (Dhjetor 2020 dhe Janar-Dhjetor 2021). Gjatë vitit 2021 të ardhurat nga tarifa janë arkëtuar brenda periudhës së parashikuar mujore.

Mosrealizimi në këtë zë vjen kryesisht nga moszbatimi i detyrimit për këto tarife nga subjektet në fushën e hotelerisë (te cilat duhet të paguajnë tarifen mbi bazën e aparateve që përdorin), por dhe në mospagimin e detyrimeve të energjisë dhe rrjedhimisht dhe të tarifës nga familjet apo subjekte të tjera. Ky mosrealizim do të minimizohej nëse do të miratohej ulja e komisionit të agjentit tatimor (për OSHEE) nga 10% në 2%.

-Të ardhurat nga vete RTSH janë realizuar në masën 74%.

a. Të ardhurat nga shërbimi në ambjentet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm janë realizuar në masën ~92%, me një mosrealizim prej 12,6 milion lekë.

- ✓ Situata paraqitet e stabilizuar përsa i takon të ardhurave nga shërbimi në stacionet e RTSH-së (20 kontrata me subjektet) dhe transmetimi në FM (një kontratë me subjektin BBC), pasi subjektet dhe të ardhurat qëndrojnë në nivelin e planifikimit në fillim të vitit.
- ✓ Situata ka qenë më e rishikuar përsa i takon të ardhurave sipas kontratave të lidhura për rrjetin numerik DVBT2.

Gjatë vitit 2021 janë larguar nga rrjeti DVBT2 6 subjekte: Scan TV, Shoqëria Media Vizion, Televizioni G2 Media, Egnatia Club tv, Syri Tv për allotmentet Korçë e Fier dhe Shoqëria BBF dhe për këtë arsye paraqitet me mosrealizim ky zë i të ardhurave.

b. Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj, janë realizuar në masën 72%, një mungesë në vlerë absolute prej 56,5 mln lekë.

Nga të ardhurat e kontraktuara gjatë vitit 2021, të ardhurat për eventin Euro 2020 zënë 50% ndaj totalit të realizimit të të ardhurave të këtij zëri gjatë vitit 2021.

Në mënyrë analitike të ardhurat e realizuara paraqiten:

-Departamenti i Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut në vlerën 139,782,986 lekë

-Qendra Vendore Audiovizive Korçë në vlerën 2,651,001 lekë

-Qendra Vendore Audiovizive Gjirokastër në vlerën 1,088,081 lekë

-Qendra Vendore Audiovizive Shkodër në vlerën 23,500 lekë

Nga të ardhurat e realizuara, vlera 40,2 milion lekë është realizuar me kontrata shkëmbimi.

c. Në zërin e të ardhurave të tjera janë realizuar të ardhurat e parashikuara në nivelin 32%.

Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga :

- ✚ qira toke, ndërtesë, bankomatesh etj.(3 mln lekë),
- ✚ shitja materialeve arkivore (73,200lekë),
- ✚ kontratat për ripërsëritjen e transmetimit nga subjektet kabllorë(3 mln lekë),


- ✚ dy grantet nga British Council për Qendrat Vendore Audiovizive Korçë (vlera 2,7 mln lekë) dhe Gjirokastër (vlera 2,7 mln lekë), në kuadër të projektit “Fuqizimi i Diversitetit dhe Qëndrueshmëria e Medias Vendore”,
- ✚ të ardhura të tjera të rimbursuara nga kontratat me jashtë për sporte dhe shpenzime page për një punonjës në stacionin e Cërrikut etj.(rreth 5 mln lekë), etj.

Gjatë vitit 2021 nuk u arkëtua e ardhura e parashikuar nga Shoqëria Aksionere Eutelsat, parashikuar në vlerën 12 mln lekë, e ardhur kjo që pritet të realizohet gjatë vitit 2022, për arsye të elementeve të sigurisë që kërkonte Banka Societe Paris për të kaluar transfertën.

Gjithashtu edhe të ardhurat e parashikuara nga shitja e biletave, për arsye edhe të situatës së pandemisë nuk janë arkëtuar gjatë vitit 2021.

Të ardhurat nga biletat e festivalit të 60-te te kenges se fundvitit prej 1,6 milione leke (u shfrytezua 50% e kapacitetit te vendeve ne salle), jane arketuar ne muajin janar 2022.

Realizimi i të ardhurave gjatë tre viteve të fundit:



Në 000/lekë

TE ARDHURAT	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
I Financimi nga buxheti	674,000	633,134	573,736
Bashkatdhetarët & Sateliti	240,000	270,000	220,000
Projekte Filmike&Artistike	74,000	60,000	60,000
Orkestra Simfonike RTSH-së dhe kinematografisë	60,000	54,000	60,000
Investime në Teknologji	100,000	69,134	17,736
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	200,000	180,000	216,000
II.Të ardhura nga tarifa ap.tv	1,249,405	1,139,491	1,363,257
III.Të ardhura të Institucionit	303,227	225,727	296,943
Të ardh. Shfrytëzimi i Infrastrukturës Transmetuese	85,903	122,507	137,397
Reklama, njoftime etj.	83,824	78,460	143,546
Kontrata e Radiobashkëpunimit me Kinën	76,000		
Të ardhura të tjera	57,500	24,760	16,000
TOTALI I+II+III	2,226,632	1,998,352	2,233,936

Nisur nga të dhënat e tabelës:

-Të ardhurat nga financimi buxhetor paraqiten me ulje gjatë dy viteve të fundit.

-Të ardhurat nga tarifa shërbimit të përdorimit të aparatit tv paraqiten me një rritje në vitin 2021, por në fakt në këtë vlerë është përfshirë edhe arkëtimi i vlerës 98 milion lekë, e cila duhej të ish arkëtuar në vitin 2020. Niveli mesatar vjetor i arkëtitimit të tarifës (ne 3 vitet e fundit) rezulton 1,250,000,000 lekë.

-Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese paraqiten me të larta gjatë vitit 2021, si rezultat i faturimit të të gjithë allotmenteve, ku peshën më të madhe e ka allotmenti i Tiranës.

-Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj. paraqiten më të larta si rezultat i eventeve sportive, kryesisht Euro 2020 transmetuar gjatë vitit 2021.

-Të ardhurat e tjera paraqiten me ulje si rezultat i mosarkëtitimit brenda vitit i të ardhurave nga Eutelsat, parashikuar në vlerën 12 milion lekë, si dhe te ardhura të tjera.

B.Detyrimet e pritshme për arkëtim

I. INFRASTRUKTURA TRANSMETUESE RTSH			
Nr	Subjektete	Detyrimi	Periudha
1	Reparti ushtatark 6640	540,000	Dhjetor '21
2	Drejtoria Pergjithshme e Burgjeve	108,000	Dhjetor '21
3	Banka e Shqiperise	180,000	Dhjetor '21
4	Sherbimi Informativ Shtetror	720,000	Dhjetor '21
5	UNDP	144,000	Dhjetor '21
6	Drejt.Rajonale Kufirit Gjirokaster	72,000	Nëntor-Dhjetor '21
7	Insituti Ekzekutimit Veprave Penale Lezhe	36,000	Dhjetor '21
8	Drejt.Vendore Kufirit dhe Migracionit Vlore	36,000	Dhjetor '21
9	Radio Klan	118,254	Dhjetor '21
10	TV Kombetar Klan	198,981	Dhjetor '21
11	Drejtoria Policise Elbasan	72,000	Nëntor-Dhjetor '21
12	Insituti Ekzekutimit Veprave Penale Korce	36,000	Dhjetor '21
13	Drejtoria Vendore Policise Gjirokaster	36,000	Dhjetor '21
14	Top Albania	390,557	Nëntor-Dhjetor '21
	Totali 1.	2,687,792	
1	Media SHA TV Shijak	6,647,514	Prill'20-Dhjetor'21
2	Fax Media News	4,578,611	Tetor'20-Dhjetor'21
3	Multiscreen shpk	3,176,943	Nëntor-Dhjetor '21
4	3DS& AF Entertatinment	2,513,207	Maj-Dhjetor'21
5	6+1 Vlora shpk	1,489,614	Korrik-Dhjetor'21
6	Fokus Media	1,472,920	Nëntor-Dhjetor '21
7	Media Motiv	1,339,377	Gusht-Dhjetor'21
8	Star News rtv	1,304,862	Maj-Dhjetor'21
9	FKT shpk TV Apollon	1,048,483	Korrik-Dhjetor '21
10	TV Premium Channel	976,257	Nëntor-Dhjetor '21
11	Alban Shehu	798,424	Qershor-Dhjetor'21
12	TV Sot 7	722,177	Gusht-Dhjetor'21
13	UTV Education	704,129	Tetor'21
14	Panorama	695,580	Nentor
15	Channel 7	679,341	Prill-Dhjetor'21
16	TV Klaudiana	648,569	Korrik-Shtator'21
17	Media BS	641,708	Shtator-Dhjetor '21
18	One TV Vlora	543,387	Tetor-Dhjetor '21
19	AMG 2000	447,752	Korrik-Dhjetor'21
20	Antena Nord	323,147	Nëntor-Dhjetor '21
21	TV Kopliku	313,406	Nëntor-Dhjetor '21
22	Johaniter	271,665	Janar '21
23	Media Nord	160,905	Dhjetor '21
24	R&T shpk	180,000	Janar-Maj '21
25	Rozafa	144,000	Shtator-Dhjetor '21
26	Lulzim Ahmetaj taxi lux	108,000	Tetor-Dhjetor'21
27	Vani	81,422	Dhjetor '21
	Totali 2	32,011,400	
	TOTALI 1+2	34,699,192	

Ecuria e arkëtimeve ka vijuar me problematikat e arkëtimeve pjesore nga shumë subjekte. Gjatë muajit Dhjetor vlera e faturuar është 8.9 mln lekë. Detyrime të mbartura nga viti 2020 janë në vlerën rreth 5 mln lekë. Vlera 21 mln lekë paraqet detyrimin që duhej të arkëtohej brenda vitit 2021.

II. REKLAMA,NJOFTIME,QERA etj.			
Nr	Subjektete	Detyrimi	Periudha
1	Vodafon	4,382,498	Korrik '21
2	Ovation Advertising	484,356	Maj-Dhjetor'21
3	One communication(+ogilvy)	5,315,250	Gusht-Dhjetor'21
4	EHW	369,040	Tetor-Dhjetor '21
5	Landmark communications	197,140	Pjes.'18,Shtator'20
6	Eurosig	9,619,731	Shtat.'19,Dhjetor '20-'21
7	Birra Tirana	50,000	Viti 2018
8	Coca Cola	154,732	Dhjetor '21
9	Red Bull	173,268	Tetor-Dhjetor '21
10	Mindshare	126,591	Nëntor-Dhjetor '21
11	Glen Deda	452,954	Dhjetor ' 19
12	Billa& Co	57,240	Dhjetor '21
14	Intermedica	381,600	Nëntor-Dhjetor '21
15	Artmotion	2,041,292	Nëntor '21
16	OMD Media	482,259	Korrik '21
17	Unlimited Media	1,859,832	Nëntor-Dhjetor '21
18	Qafe Shtatma	261,501	Tetor '21
19	Lutecredit	38,436	Dhjetor '21
20	Raiffeisen Bank	12,200	Nëntor-Dhjetor '21
21	Union Bank	30,185	Dhjetor '21
22	Tirana Bank	12,020	Dhjetor '21
23	Digitalb	647,607	Dhjetor '21
24	Berlin-Chemie	504,000	Tetor-Dhjetor '21
25	New Moment New Ideas	45,000	Dhjetor '21
26	Landway International	451,242	Dhjetor '21
27	Gri Collective	106,403	Dhjetor '21
28	OTP bank	103,846	Dhjetor '21
29	1 UP	33,920	Nëntor '21
30	Unioni financiar	189,432	Dhjetor '21
31	Memento	99,725	Dhjetor '21
	Totali	28,683,300	

Ecuria e arkëtimeve ka vijuar me problematikat e arkëtimeve pjesore nga shumë subjekte. Detyrime të mbartura deri në vitin 2020 janë në vlerën rreth 10 mln lekë.

Vlera 5 mln lekë paraqet detyrimin që duhej të arkëtohej brenda vitit 2021, për të cilën po ndiqen procedurat e njoftimeve nga Drejtoria e Shitjes dhe Menaxhimit të trafikut.

Vlera 63 milion lekë përbën detyrimet e pritshme për t'u arkëtuar gjatë vitit 2022.

Sikurse është vepruar edhe vitet e tjera, për disa subjekte kanë nisur procedurat për ndjekjen e detyrimeve në rrugë gjyqësore.

Në muajin Qershor 2021 nisën procedurat gjyqesore për subjektet G2 Media (798,871 lekë), Shoqëria Egnatia (2,653,022 lekë), 3DS&AF Entertainment(1,991,760 lekë) dhe BBF (3,506,000 lekë).

Gjatë vitit 2021 u arkëtuan vlerat 5,443,653 lekë, nga tre subjektet e parë, ndërsa vijojnë procedurat me subjektin BBF.

Gjatë vitit 2021 u zgjidh me pajtim me shkëmbim detyrimi nga Subjekti Media Vizion në vlerën 3,487,459 lekë .

Në vijim paraqesim listën e subjekteve në proces gjyqësor.

C. SUBJEKTE QE PO NDIQEN NE RRUGE GJYGJESORE				
Nr.	Subjekte	DETYRIM MBARTUR	Det. Viti 2021	Detyrime
	Subjekte që janë në përbarim	4,810,220		4,810,220
1	Media Art	134,994		134,994
2	Centrum Production	375,333		375,333
3	Kompania MCDR Shiroka	400,000		400,000
4	Star Airways Albania	157,205		157,205
5	2 AL shpk	815,000		815,000
6	Menocon internet	292,000		292,000
7	KESH	499,500		499,500
8	“ALSAT” sh.a.	115,720		115,720
9	Alfatelekom	918,000		918,000
10	<i>Emiliano Hoxhaj</i>	1,102,468		1,102,468
	Subjekte në Proces gjyqësor	7,923,633	3,915,078	11,838,711
11	<i>Teknomedia Naser TV (shqyrtim ne apel)</i>	1,492,639		1,492,639
12	Shoqëria Ora sha (Proc.gjyqësor shkalla pare)	146,121		146,121
13	<i>Shoqëria Channel one shpk (shqyrtim ne apel)</i>	510,829		510,829
14	Gener 2 (Proc.gjyqësor shkalla pare)	1,062,880		1,062,880
15	Extra Channel (Proc.gjyqësor shkalla pare)	3,704,210		3,704,210
16	Tv Kukes (Proc.gjyqësor shkalla pare)	631,954		631,954
17	Kelmend (shqyrtim ne apel)	375,000		375,000
18	BBF Fillim I Proc(Fatur.deri maj 2021)		3,915,078	3,915,078
	Fituar e në proces gjyqësor per t'u arkëtuar	12,733,853	3,915,078	16,648,931


C.Realizimi i shpenzimeve në krahasim me parashikimin per vitin 2021:

në 000/lekë

Nr	Emertimi	Parashikm Viti 2021	Realizimi Viti 2021	Real. ne %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	924,400	915,597	99
2	Materiale,lende djegese	61,400	61,700	101
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav.	316,000	315,684	100
4	Organizma Nderkombetar	90,000	86,161	96
5	Shërbime nga të tretë	278,700	264,259	95
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	65,000	61,127	94
7	Shpenzime të tjera operative	67,800	66,576	99
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	332,700	287,982	87
9	Shpenz.këste e interesa kredie	320,000		
	Shpenzimet gjithsej	2,456,000	2,059,086	83,9%

Shpenzimet e RTSh-së gjatë vitit 2021 janë realizuar në nivelin 83.9 %.

Struktura e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2021, paraqitet në mënyrë grafike si vijon:



***Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime** është realizuar 99% dhe përbën 45% të shpenzimeve faktike të RTSH-së. Gjatë vitit 2021 janë reflektuar ndryshimet strukturore dhe të rritjes së kategorive të pagave në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues RTSH nr.28 datë 22.07.2021, si edhe ndryshimet brenda për brenda strukturave.

Nga 1040 vënde pune miratuar në strukturë gjatë vitit 2021, numri mesatar mujor i punonjësve gjatë vitit 2021 ishte 968, në fund të vitit 2021 është 965 punonjës.

Sipas strukturave të vartësisë shpenzimet për paga, mbikohje, sigurime shoqërore e shëndetsore, paraqiten në raportet :

-Drejtoria e Përgjithshme RTSH (Administrata, Orkestra, Arkiva dhe Departamenti i Prodhimit) në vlerën 341,7 mln lekë ose 37 % ndaj totalit.

-Njësia Teknike në vlerën 244,9 mln lekë ose 27 % ndaj totalit.

-Njësia Emisioneve Tematike dhe Lajmeve në vlerën 149,4 mln lekë ose 17% ndaj totalit.

-Njësia e Programeve në vlerën 85.5 mln lekë ose 10% ndaj totalit .

-QVA Korçë në vlerën 26.8 mln lekë ose 2.5% ndaj totalit.

-QVA Gjirokastrë në vlerën 24.9 mln lekë ose 2.5% ndaj totalit.

-QVA Shkodër në vlerën 23 mln lekë ose 2% ndaj totalit.

-QVA Kukës në vlerën 18 mln lekë ose 2% ndaj totalit.

Zëri i shpenzimeve për paga dhe mbikohje kategorizuar në Administratë, Krijimtari dhe Teknikë paraqitet :

-Administrata në vlerën 134 mln lekë ose 17 % ndaj totalit të fondit të pagave

-Krijimtaria në vlerën 274 mln lekë ose 35 % ndaj totalit

-Teknika në vlerën 368 mln lekë ose 48% ndaj totalit.

***Zëri Materiale** përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse, lëndë djegëse(karburant), realizuar në nivelin 100% .

Përqindjen më të lartë të realizimit me 50% , e zënë **shpenzimet për furnizimin me karburant** për :

- Gjeneratorët në 62 stacionet, radiostacionet në Njësinë Teknike (115,000 litra në vit),
- Shpenzimet për automjetet (rreth 82,000 litra)

Për sa i takon shpenzimeve për zërat materiale, shpenzimet kryesore lidhen kryesisht e blerjet për materiale teknike dhe ndihmëse, për:

- Sektorin elektrik, Sektorin e transmetimit, Sektorin IT, Orkestrën Simfonike RTSH, Departamentin e Prodhimit, blerje kanceleri dhe bojra printer ,blerje për Automjete, blerje material kozmetike, detergjente, dizifektues, hidraulike, veshje etj

***Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike & Fondi i prodhimit të pavarur**, përfshin:

a)të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, është realizuar 100% në vlerën 167mln lekë.

-Blerje e të drejtave sportive për aktivitetet Euro 2020, Botërori 2022, Formula 1, Roland Garros Tennis, Uefa Champions League, Kupa Gjermanisë, Anglisë, Spanjës, prodhim sinjali i ndeshjeve të Kombëtares, likuiduar sipas kuotave të parashikuara për vitin 2021, Olimpiada etj. janë realizuar në vlerën 141 mln lekë.

-Blerje të drejta transmetimi dokumentarë, filma në vlerën 26 mln lekë.

b)Projekte filmike e Artistike, bashkëprodhime realizuar në vlerën 133,7 mln lekë dhe përfshijnë :

-Në Drejtorinë e Përgjithshme janë realizuar projektet në vlerën 74.7 mln lekë: « Eurosong » , « Festivali Junior » , « Miss Globe » , « Buke dhe Cirk » , « Festivali Këngës RTSH » , « Grand Gala » .

-Në Njësinë e Programeve janë realizuar projektet e strukturës në vlerën 41.3 mln lekë. Në Radio janë realizuar emisionet e strukturës në vlerën 6.6 mln lekë dhe në Televizion janë realizuar projektet :

« 4 Stinët » , « Pasditja ime » , « Ura » , « Eja tek unë » , « Ditë pas dite » , « Mirëmengjes Shqipëri » , « Transkulturë » , « Artes » , « Dimensionin 4 » , « Ne » , « Siluetë » , « Gjuha e shpirtit » , « Rrënjët e ushqimit tënd » , « Tempull » , « Individin dhe Shoqëria » , « Art&Art » , « Klubi i të rinjve » , « Perspektivë » « Bibliotekë » , « Zëri i Popullit » , « Fletorja Zyrtare » , « Newseum » .

-Në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve janë realizuar projektet e strukturës, në vlerën 18 mln lekë.

- « Dekalog » , « Përballë » , « Autor » në vlerën 0.8 mln lekë, « Target » , « 31 minuta » , « Java RTSH » & « Java mesnatë » , « Në gjuhën e shenjave » , « Thirrja e Tokës » , « Euro 2020 » , « Skalitur në Përjetësi » , « Publikisht »

c)shpenzimet për fondin e prodhimit të pavarur, janë realizuar në vlerën 15 mln lekë gjatë vitit 2021.

-Prodhimi e programit të pavarur: Serialit televiziv « Nina » prej 10 serish në vlerën prej 10 mln lekë.

-Prodhim i porositur për 10 dokumentarë « Koha dhe Artisti » në vlerën 5 mln lekë.

***Zëri i Organizmave Ndërkombëtare** përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare, si:

-Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor në vlerën 28 mln lekë nga 31 mln lekë parashikuar, si rezultat i kërkesave më të ulta për shërbime satelitore ndaj subjektit Ses Astra, në varësi të aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2021.

-EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme; pagesat e kuotizacioneve ndaj organizmave ndërkombëtare: EBU, Circom, Copeam, Rai, URT, AFP, Kosova Press, Erno. Realizimi i këtij zëri gjatë vitit 2021 është në masën 99%.

***Zëri i Shërbimeve nga të tretë** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qira të ambjenteve, si dhe shpenzime të tjera. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 95%, dhe në mënyrë analitike paraqitet:

-Shpenzimet për energji elektrike në vlerën 79.2 milion lekë nga 92.5 milion lekë parashikuar, realizuar në masën 86%.

-Shpenzimet për ujë, telefon, postë në vlerën 9.7 milion lekë realizuar në masën 80%.

-Shpenzimet e internetit dhe fibrave optike në vlerën 19.8 milion lekë, realizuar në nivelin 94%.

-Shërbimi i ruajtjes fizike në vlerën 19.8 milion lekë, realizuar në masën 99%.

-Shpenzimet për qira për pronarët e truallit ku janë ndërtuar kullat e transmetimit gjatë procesit të digjitalizimit në vlerën 14.6 milion lekë në Drejtorinë e Përgjithshme, kontrata në vlerë 4.1 milion lekë për përdorimin e linjave elektrike për stacionet Dvb-t2 në Njësinë Teknike, në një total prej 18.8 milion lekë, realizuar në nivelin 92%.

-Shpenzime të tjera realizuar në vlerën 117 milion lekë, nga 113 milion lekë parashikimi, diferencë kjo si rezultat i proceseve gjyqësore të humbura nga RTSH në vite dhe ekzekutuar nga përmbarimi gjatë vitit 2021.

Në mënyrë analitike ky zë përfshin:

- shpenzimet për të drejtën e autorit në vlerën 14.8 mln lekë

- shpenzimet për shërbimet në platformën OTT dhe playout support në vlerën 50.5 mln lekë, kontrata të cilat përfundojnë në dhjetor të vitit 2022.

-shpenzimet për mirëmbajtjen head end satelitor në vlerën 4.5 mln lekë, kontratë e cila përfundon në vitin 2024.

-shpenzimet për siguracione shëndeti (me kontrate shkëmbimi) dhe automjete 14.7 mln lekë

-shpenzimet për frekuencat AKEP në vlerën 14.5 mln lekë.

-shpenzimet për prurësin e reklamave në vlerën 8.2 mln lekë

-qira e shpenzime të tjera koncerte e aktivitete në vlerën 4.1 mln lekë

-shpenzime shërbime automjetesh e qira pajisjesh në vlerën 2 mln lekë

-shpenzimet gjyqësore në vlerën 3.6 mln lekë

***Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta** është realizuar në masën 94% . Diferenca e mosrealizimit paraqitet kryesisht në Njësinë Teknike.

Realizimi në këtë zë qëndron në raportet : ~65% për shërbim udhëtimi jashtë vendit dhe ka mbuluar kryesisht pasqyrimin e aktiviteteve ndërkombëtare të zhvilluara gjatë vitit 2021.

~35% për shërbime brenda vendit në të gjitha strukturat e vartësisë,

Shërbimet brenda vendit në mënyrë analitike paraqiten:

~54% e përbëjnë shpenzimet në Njësinë Tematike dhe të Lajmeve, të cilët pasqyrojnë ngjarjet dhe aktivitetet kryesore në mbarë vendin.

~17% e shpenzimeve janë në Njësinë Teknike për për regjistrimin dhe transmetimin e aktiviteteve sportive e artistike, si edhe për riparimet e defektet që ndodhin në stacionet rtv e furnizimin me karburant të gjeneratorëve në stacionet rtv.

~ 29% e shpenzimeve janë në Departamentin e Prodhimit e Njësinë e Programeve, në QVA Gjirokastër, në QVA Kukës, QVA Shkodër, e QVA Korçë për lëvizjet sipas strukturës programore.

***Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar në nivelin 99%. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për :

- Honorare në Departamentit e Prodhimit, aktivitetet e Orkestrës, Njësinë Tematike dhe lajmet, Njësinë e Programeve dhe Qendrat vendore audiovizive, bazuar në strukturën programore të vitit 2021 në vlerën 38 milion lekë.
- pagesat e Këshillit Drejtues dhe Bordeve te RTSH në vlerën 10 milion lekë,
- pagesat e kujdestarëve të stacioneve transmetuese në Njësinë Teknike, në zbatim të vendimeve të Këshillit Drejtues RTSH në një vlerë 17 milion lekë
- pagesat taksa automjetesh e bashkije në një vlerë 1.4 milion lekë

***Zëri i shpenzimeve për Investime dhe mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit** realizuar në masën 87%, vjen si rezultat i mosrealizimit të investimeve në teknologji.

***Investime në Teknologji** Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për investime në teknologji:

- Blerje pajisjesh dhe Software(program) për postën elektronike RTSH - në vlerën rreth 6.3 mln lekë, realizuar nga Financimi Buxhetor
- Furnizim vendosje transmetuesa dhe Sisteme Antena FM për stacionet Tarabosh, Himarë, Zvërnec, Tushemisht dhe Llogara - në vlerën rreth 9 milion lekë, realizuar nga financimi buxhetor.
- Rinovimi i pajisjeve elektrike për studiot në RTSH, realizuar - në vlerën rreth 3 milion lekë, realizuar si vlerë pjesore e tenderit të parashikuar Blerje Video Wall, Pajisje Ndriçimi dhe Rinovim i pajisjeve elektrike në studiot e RTSH-së.

Investimet janë realizuar në masën 21%, si rezultat i mosrealizimit në afat të kontratës së parashikuar në vlerën nga financimi buxhetor nga subjekti kontraktues.

Investimet e parashikuara prej 32.4 milion lekë nga financimi buxhetor dhe 20 milion lekë parashikuar nga të ardhurat e veta, nuk u realizuan gjatë vitit 2021.

***Zëri i shpenzimeve të mirëmbajtjes** është realizuar në vlerën 269.7 mln lekë, në zbatim të kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit të firmosur gjatë muajit shkurt 2021. Diferenca vjen si efekt i ndryshimit të vlerës së kontratës gjatë vitit 2021. Kjo kontratë vazhdon deri në vitin 2025.

***Zëri i shpenzimeve të kësteve dhe interesave të kredisë nuk është realizuar** si rezultat i mungesës së të ardhurave, pamundësisë financiare të RTSH-së për përballimin e këtij shpenzimi, relatuar në të gjitha shkresat dërguar në Ministrinë e Financave.

-Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH gjatë tre viteve të fundit

Emertimi	Realizimi Viti 2019	Realizimi Viti 2020	Realizimi Viti 2021
Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	783,440	824,569	915,597
Materiale,lëndë djegëse	64,785	67,964	61,700
Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	338,287	307,526	315,684
Organizma Ndërkombëtarë	86,967	86,066	86,161
Shërbime nga të tretë	233,961	225,755	264,259
Shpenzime udhëtimi e dieta	86,498	61,469	61,127
Shpenzime të tjera operative	60,811	61,050	66,576
Investime dhe mirëmb. rrjeti digj.	443,684	344,647	287,982
TOTALI	2,098,433	1,979,046	2,059,086

Nga krahasimi në vitë ndryshimet në zëra paraqiten :

- Rritje në zërin e pagave, sigurimeve shoqërore e shendetesor, e bazuar në ndryshimet strukturore organizative dhe rritja e pagave gjatë muajve prill 2020 dhe shtator 2020 për gjithë sistemin e RTSH.
Gjithashtu gjatë vitit 2021 pati rritje të pagave të ulta, si edhe rritje të pagave në Qendrat Vendore audiovizive. Pagat paraqiten 11% më të larta gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020.
- ndryshimet strukturore programore për zërin e shpenzimeve të tjera operative (honoraret/projekte filmike e artistike kanë sjellë rritjen e honorareve gjatë viti 2021 me 9%.
- Rritja me 17% në shërbimet për të tretë vjen si rezultat i kontratave të shërbimit të mirëmbajtjes të lidhura në fund të vitit 2020.

RTSH gjatë gjithë vitit 2021 ka ndjekur hap pas hapi situatën financiare, duke likuiduar vetëm shpenzimet e domosdoshme për të realizuar detyrimet kontraktore brenda afateve.

RTSH mbart detyrime te papaguara nga viti 2021, si vijon:

- Këstiet e kredisë së vitit 2021 ~320 milion lekë
(mbart këstiet e kredisë të viteve 2018–2020 ~ 841 mln.lekë)
- Detyrime të krijuara deri në muajin nëntor 2021 ~ 70 milion lekë
(Situata qëndron më e mire se në vitet e kaluara). Pa përfshirë këtu detyrimet e krijuara në muajin dhjetor, të prishme për t'u likuiduar në janar 2021 në vlerën ~60 mln lekë.

Krahas analizave të detajuara të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, në mënyrë të përmbledhur RTSH mbyll vitin 2021 me diferenca te parase se gateshme (CASH) në vlerën ~ 271 milion lekë, si vijoj:

- Vlera e munguar nga realizimi i te ardhurave nga tarifa aparatit tv 87 milion leke
- Vlera e munguar nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese 13 milion lekë
- Vlera e munguar nga reklamat 57 milion lekë
- Vlera e munguar nga të ardhurat e tjera 34 milion lekë
- Detyrimet që duhet të arkëtohen në fakt 40 milion lekë
- Vlera e kontratave të shkëmbimit në vitin 2021 40 milion lekë